

## Zëvendësimi dhe lidhja zëvendësuese në tekstin koheziv



Gjuhësi

Fjalë kyçe: kohezion, tekst, zëvendësim (pro form), anafore, katafore, perberes sintaksor.

Lutfije Cota

Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan. Fakulteti i Shkencave Humane.  
Departamenti i gjuhëve Angleze dhe Gjermane.

### Abstract

The central role of grammar in the study of language has become an established tenet of modern linguistics. Outside it the status of this subject has in recent decades been the subject of much controversy. Currently there is a movement which again recognizes the importance of grammar in general education. The fundamental purpose of the language is to make sense to communicate intelligibly. For this we need to share a single system of communication. The rules controlling the way a communication system works are known as its grammar and both sender and recipient need to use the same grammar if they are to understand each other. This work mentions the role and importance of grammar in foreign language teaching. It focuses especially on the need to change from artificial prescriptive grammar teaching to contextualized grammar instruction.

Një element i kohezionit që ndihmon në unitetin dhe vlefshmërinë e tekstit janë fjalet zëvendësuese ose pro-format. Trajtime interesante mbështetur me argumente bindëse të autorëve të ndryshëm të gjuhës angleze janë bërë pikë referimi për gjuhëtarët e rinj në analizën e kohezionit të tekstit, përfshirë zëvendësimin si një element mjaft i rëndësishëm koheziv. Me zëvendësimin gramaticienët anglezë Quirk dhe Greenbaum në librin e tyre “*A Comprehensive Grammar of English Language*” (1993) kuptojnë lidhjen midis dy elementëve që i përkasin së njëjtës gjë.<sup>121</sup> Fjala që zëvendëson, nënkupton elementin paraprijës. Elementet zëvendësues ndihmojnë në shmangien e përsëritjes dhe mbështeten tërësisht në aftësinë e dëgjuesit dhe lexuesit për marrjen e informacionit nga konteksti.

(1) A: - *Can I have a cup of black coffee with sugar, please?*

B: - *Give me the same, please.*

(A: - *Mund të më sillni një kafe me sheqer ju lutem?*

-B: *Të njëjtën gjë dhe mua, të lutem*) (zëvendësim emëror) (nominal substitution)

(Greenbaum, S., Quirk, R., (1993), *A student's grammar of English language*, Longman: 256)

(2) Ai e *ndezi zjarrin me ngathtësi, që tregonte se e bënte këtë gjë tepër rrallë.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*:166)

Fjalët *the same / të njëjtën gjë, bënte këtë gjë* nuk nënkuptojnë identitet, por ngjashmëri me elementin paraprijës.

Martin Parrot, një tradicionalist i vlerësuar si një nga metodistët më të mirë, në librin e tij “Grammar for English Language Teachers” njihon termin zëvendësim me referim, ku në të përfshin fjalë që shërbejnë si tregues se diçka është lënë jashtë për t’u zëvendësuar me to. Gjenerativistët Halliday dhe Hasan në librin e tyre “Cohesion in English” e përcaktojnë zëvendësimin si një marrëdhënie brenda tekstit, fjalën zëvendësuese një lloj njehsuese e cila përdoret në vend të përsëritjes së një elementi të caktuar duke marrë të njëjtin funksion strukturor me elementin që zëvendëson.<sup>122</sup>

(3) *The children work very hard in the garden. They must do.*

(*Fëmijët punojnë shumë në kopsht. Ata duhet të punojnë.*)

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 130)

Në shembullin (3) *do* funksionon si fjalë kokë e përbërësit foljor dhe zëvendëson fjalën kokë të përbërësit foljor paraprijës. Në shembullin shqip përbërësi sintaksor rimerret me përsëritje. Përdorimi i zëvendësueses foljore *do* është më shumë veçori e gjuhës angleze. Në anglishten Britanike ajo zëvendëson çdo folje përveç foljes *be*. Ajo përdoret më shumë në gjuhën e folur sesa në gjuhën e shkruar, si edhe më shumë në anglishten Britanike se sa në anglishten Amerikane.

Nga autorët shqiptarë Dibra dhe Varfi në librin e tyre “Gjuhësi teksti” i quajnë fjalët zëvendësuese “*pro-forma*”. Pro-format janë fjalë të shkurtra, ekonomike, pa ndonjë kuptim të veçantë, sepse aktualizojnë kuptimin e tyre vetëm brenda tekstit. Ato mund të bëhen të pranishme në tekstin sipërfaqësor për të zëvendësuar fjalë ose shprehje të caktuara të veshura me përmbajtje. Pro-format u lejojnë përdoruesve të tekstit ta kenë të lehtë kontrollin e përmbajtjes në kujtesën e tyre, pa përsëritur të gjithë tekstin.<sup>123</sup>

Sipas Anila Çepanit në “Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe” (2007) midis pro-formave veçohen ato foljore. Ato përdoren kryesisht me foljen *bëj, ndodh* ose me ndonjë folje tjetër që shënon proces.<sup>124</sup> Në fjalinë:

(4) *Djaloshi lëvizti kokën mënjane siç bëri plaku*

(Çepani, A. (2007), *Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe*, SF, Nr. 3-4: 104)

<sup>121</sup> Greenbaum, S., Quirk, R., *A student's grammar of English language*, Longman, 1993, f. 247

<sup>122</sup> Halliday, M. A. K, Hasan, R., *Cohesion in English*, Longman, 1976, f. 89

<sup>123</sup> Dibra, K., Varfi, N., *Gjuhësi i tekstit*, shblu, Tiranë, 2005, f. 47

<sup>124</sup> Çepani, A., *Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe*, SF 2007, Nr. 3-4, f. 104

Interpretimi i foljes *bëri* është përcaktuar nga marrëdhënia anaforike e vendosur midis saj dhe paraprijësit *lëvizi kokën mënjane*. Në rastet e anaforave foljore nuk ka bashkëreferim.

Ndërsa Tefë Topalli në librin e tij “Gjuhësi Teksti” e përdor termin zëvendësim si “teknikë për të rithënë, pa përsëritur atë që është thënë në një tekst. Kështu një fjalë ose një vazhdim fjalësh mund të zëvendësohen me: përemra, proforma sinonime, hiperonime, emra të përgjithësuar, riformulime. Për proformat ai përmend fjalët *i njëjtë, i tillë, i atillë* të cilat mund të quhen “*përmbiemra*” e mund të zëvendësojnë mbiemra të tërë ose elemente vazhdues të tekstit, *kështu, ashtu, në atë mënyre* si ndajfolje mund të zëvendësojnë mbiemra e ndajfolje të tjera ose segmente vijuese të tekstit.<sup>125</sup>

(5) “*Klaudi është i këndshëm dhe inteligjent*”

“*Nuk ndodh shpesh të njohësh një djalë të atillë.*”

“*Ah, jo, me të vërtetë, ndodh rrallë të njihesh me një djalë ashtu. (të këndshëm dhe inteligjent)* (Topalli, T. (2011), *Gjuhësi Teksti*, Shkodër: 101)

(6) *Ai tendosi qafën, sepse iu duk se dëgjoi zhurmë pas derës. Ishte vërtet ashtu.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 143)

Autori shqiptar, Shezai Rrokaj, përdor termin lidhëzor ndërfrazorë, me të cilët kupton mjetet që garantojnë vazhdimësinë e tekstit në mënyrë të tillë që të ketë një qasje sa më të plotë midis ngjarjes dhe kontekstit. Flora Koleci me zëvendësim kupton rimarrjen e një përbërësi nga një fjalë e vetme, zakonisht një klitik.

Duke përcaktuar sërish si kriter të klasifikimit funksionin gramatikor të elementit zëvendësues, ashtu si elipsa, zëvendësimi në gjuhën angleze klasifikohet në zëvendësim emëror, foljor dhe fjalior.

#### A Zëvendësimi në përbërësin sintaksor emëror

Në zëvendësimin emëror fjalët zëvendësuese *one/ones* gjithmonë funksionojnë si fjalë kokë të përbërësit sintaksor emëror dhe mund të zëvendësojnë një element që në vetvete është fjala kokë e një përbërësi sintaksor emëror paraprijës.<sup>126</sup>

(7) *I wake up on Monday morning feeling totally bouncy and positive, and get dressed in my usual work outfit of jeans and a nice top, this one from French connection.*

(*Zgjohem të hënë në mëngjes duke u ndjerë mirë e bukur dhe vishem me rrobat e mia të zakonshme të punës, pantallona xhins dhe një bluzë të bukur, atë nga French Connection.*)

(Kinsella, S. *Can you keep a secret?*: 61)

(8) *Me një fjalë jemi para një rasti vërtet unik në historinë tonë, pikërisht atë të rivlerësimit dhe ndreqjes.* (Gazeta *Shekulli*, 12/06/07)

Në shembullin (7), (8) fjalët *one* dhe *atë* janë zëvendësues të elementit paraprijës në anglisht dhe në shqip. Ato kanë zëvendësuar vetëm fjalën kokë të përbërësit paraprijës. Të dy përbërësit nuk është e nevojshme të kenë të njëjtin funksion në fjali. Në disa raste elementi i presupozuar mund të ndodhet në brendësi të një përbërësi kompleks.

(9) *If only I could remember where it was that I saw someone putting away the box with those candles I could finish the decorations now. -You mean the little coloured ones?*

(*Sikur të mundesha të kujtoja se ku ishte që pashë dikë të çonte në vend kutinë me ato qirinj do të mund të përfundoja zbukurimet tani. - E ke për ato të voglat me ngjyrë?*)

(Halliday, M. A. K., Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 91)

(10) – *Ti mendon se është e mundur ose e arsyeshme që ligjet e sotme të zëvendësohen nga ato të kryehershmet?* (I. Kadare, *Prilli i thyer*: 70)

Fjala zëvendësuese mund të ndryshojë nga fjala paraprijëse në numër. Në këtë rast kemi rimarrje të pjesshme ose (identitet të pjesshëm).

(11) *This copy of the notice is blurred, but the other ones appear to be satisfactory.*

(*Kjo kopje e njoftimit është e paqartë, por të tjerat duket të kënaqshme.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1462)

(12) *The brief life of a magnater means that new ones must form at a rate of about one every thousand years in our galaxy.*

(*Jeta e shkurtër e një magneti do të thotë se të rinjtë /magnetet e rinj duhet të formohen me një shpejtësi një në çdo një mijë vjet në galaktikën tonë.*)

(*Discover*, Feb 2006:26)

Në të dy shembujt gjegjës në shqip forma eliptike është më e pranueshme sesa zëvendësimi apo rimarrja e drejtpërdrejt e elementit paraprijës dhe caktuesorët e përbërësit sintaksor emëror paraprijës janë në trajtën e shquar. Në përbërësin eliptik ato kanë funksionin e fjalës kokë.

<sup>125</sup> Topalli, T. *Gjuhësi Teksti*, Shkodër, 2011, f. 101

<sup>126</sup> Halliday, M. A. K., Hasan, R., *Cohesion in English*, Longman, 1976, f. 91

Në përgjithësi përdorimi i zëvendësimit nënkupton gjithmonë përfshirjen e një elementi të ri në përbërësin e dytë me funksion kontrastues. Kjo nuk do të thotë se asnjë element caktuesor i përbërësit paraprijës nuk rimerret në përbërësin me elemente zëvendësuese. Zëvendësimi përdoret pikërisht atje ku referenca nuk është identike ose atje ku një element i ri caktuesor duhet të shtohet. Për këtë arsye fjala zëvendësuese *one* nuk mund të zëvendësojë asnjëherë një emër të përveçëm. Emri i përveçëm është unik dhe nuk mund t'i shtohet apo ndryshohet diçka. Ndërsa kur emri i panumërueshëm shërben si fjalë kokë e përbërësit sintaksor emëror, ai zëvendësohet me *some/ca* dhe jo me *one*.

(13) *This bread is stale - get some fresh Δ. (Δ = bread)*  
*(Buka është e ndenjtur - sillni ca Δ taze. (Δ = bukë))*

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 92)

Fjalët zëvendësuese *one* në numrin njëjës dhe *ones* në numrin shumës janë mjaft prodhimtare si element zëvendësues emëror në gjuhën angleze. Ekuivalenti i saj në gjuhën shqipe *një/ca* nuk gjen përdorim të gjerë si elemente zëvendësues dhe rimarrja e shprehjes gjuhësore bëhet me elipsë.

Karakteristikë për zëvendësimin emëror në të dyja gjuhët është se ai nuk ndodh kur elementi paraprijës është emër i përbërë. Nuk gjenden shembuj të tillë.

(14) *Lend me a pen. - I've only got a fountain one.*  
*(Më jep një penë. - Kam vetëm një stilograf.)*

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 97)

Në shumicën e rasteve fjala zëvendësuese *one* është anaforë. Raste të saj në rolin e kataforës janë të kufizuara. Katafora vepron brenda fjalisë dhe kështu nuk kontribuon në kohezionin e tekstit pasi tekstet përbëhen nga fjali.

(15) *She picked out the lovely ones of all the roses in the garden and gave them to me.*  
*(Ajo mblodhi më të bukurat Δ nga trëndafilat në kopsht dhe m'i dha mua.)*

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 105)

Në shembullin shqip edhe rastet me kataforë, si ato me anaforë, realizohen me elipsë dhe jo me zëvendësim.

Gjuhës angleze i njihet si fjalë zëvendësuese emërore fjala *same*. Përveç funksionit si element referues krahasues fjala *same* e shoqëruar nga nyja shquese *the* shërben si element zëvendësues emëror. Ndryshe nga fjala zëvendësuese *one* që në të shumtën e rasteve nënkupton vetëm fjalën kokë, *the same* nënkupton një përbërës të tërë sintaksor emëror duke përfshirë çdo caktuesor në të.<sup>127</sup>

(16) *A: - I'll have two poached eggs on toast please.*  
*(A: - Do të marr dy vezë të ziera me bukë të thekur, ju lutem.)*  
*B: - I'll have the same.*  
*(B: - Të njëjtën gjë do të marr dhe unë.)*

(po aty)

Në gjuhën shqipe fjala gjegjëse e *the same* është mbiemri *i njëjtë* më shpesh i shoqëruar me emrin *gjë* duke formuar përbërës sintaksor emëror zëvendësues. Mbiemri *i njëjtë* si dhe mbiemra të tjerë në gjuhën shqipe kanë aftësi emërore të qëndrueshme dhe kontekstual. Emërimi kontekstual ndodh kur brenda një njësie sintaksore për të mos e përsëritur emrin e përdorur me parë (ose edhe të papërdorur fare më parë, por që bashkëbiseduesi e njeh nga konteksti dhe rrethanat) mbiemri përdoret si emër.<sup>128</sup>

Elementi i nënkuptuar me zëvendësim emëror është pothuajse gjithmonë jofrymor. Por elementi i nënkuptuar me *same* mund të jetë edhe një mbiemër në funksionin e epitetit.

(17) *John sounded rather regretful. - Yes, Mary sounded the same.*  
*(John dukej disi i penduar. - Po, Meri dukej njësoj. (njësoj = i penduar))*

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 107)

(18) *Po kjo është qesharake, kishte thënë ajo nëpër dhëmbë, kjo është përtej qesharakes. Ashtu është, i qe përgjigjur ai, megjithatë kjo është e vërtetë.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 84)

<sup>127</sup> Halliday, M. A. K, Hasan, R., *Cohesion in English*, Longman, 1976, f. 105

<sup>128</sup> Grup autorësh, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1*, Tiranë, 2002, f. 182

Forma *do the same* reflekton prirjen e anglishtes për të shprehur një veprim në një formë të emëruar. Ajo që e dallon *the same* nga *one/ones* është se fjala zëvendësues *one/ones* është element gramatikor, ndërsa *the same* funksionon si element leksikor. Ajo bëhet bartëse e informacionit të ri veçanërisht në pozicionin fundor të saj. Është gjithashtu e rëndësishme të theksojmë se fjalët *One/ones* gjejnë përdorim më të dendur si zëvendësues emëror sesa *the same*.

(19) *Will you grab that jacket for me? – The red one, please. (one = jacket)*  
(Më jep pak *xhakëtën*. – të kuqen  $\Delta$  të lutem.) (Bodyguard, film)

(20) *‘Costume!’ I try to look surprised ‘Gosh! Um. I didn’t realize we had to have one.*  
(*Kostumin!* Oh, nuk e dija se duhej të kishim *kostum*.) (Kinsella, S., Can you keep a secret: 214)

Në shembullin (19) në shqip elipsa parapëlqehet në vend të zëvendësimit. Në shembullin (20) fjala rimerret me përsëritje të drejtpërdrejtë. Fjala *the same/e njëjta* mund të shërbejë për të gjitha llojet e zëvendësimit, jo vetëm në zëvendësimin emëror.

Zëvendësimi emëror: *the same*

Zëvendësimi foljor: *do the same*

Zëvendësimi fjalior (e raportuar): (*say*) *the same*.

Në shqip kemi ekuivalentet:

Zv. Emëror: (*e njëjta gjë*)

Zv. Foljor: (*bëj të njëjtën gjë*)

Zv. Fjalor: (*them të njëjtën gjë*)

Rast tjetër tipik i zëvendësimit emëror në gjuhën angleze është fjala zëvendësuese *so* (*kështu*), e cila zëvendëson pjesën emërore të kallëzuesit të përbërë emëror. Ajo gjendet më dendur në letërsinë artistike. Në përgjithësi *so* mund të zëvendësojë një fjali, megjithatë nuk ka një vijë të qartë ndarëse midis fjalës *so* si element zëvendësues emëror dhe fjalior.

(21) A: - *It’s difficult “I hear myself saying defensively”, there are a lot of memories in here. You can’t just throw them out.*

B: - *If you say so –Kerry rolls her eyes. If it were me, the whole lot’d go in the bin.*

(A: - Është e vështirë, - dëgjoj veten që flet duke u mbrojtur. Atje ka shumë kujtime, ndaj **nuk mund t’i flakësh dot në çast.**)

B: - *Meqë ti thua kështu. - Kerri picërroi sytë – se po të ishte për mua të gjitha do të përfundonin në kazanin e plehrave.*  
(Kinsella, S., Can you keep a secret: 56)

(22) *Vërtet kush ishte ai tjetri? Thoshin se ishte një mjek, që Binak Alia e merrte shpesh me vete në raste të veçanta, sidomos kur ishte fjala për numërimin e plagëve, zhdëmtimi i të cilave bëhej me gjobë. Po, në qoftë se ishte kështu, atëherë Binak Alia nuk kishte ardhur për ndarje kufijsh, por për ndonjë çështje tjetër, sepse dihej që në ndarjen e kufijve mjeku s’kishte kurrfarë pune.*

(I. Kadare, Prilli i thyer: 39)

Fjala zëvendësuese *so/kështu*, ashtu pozicionohet pas foljes *do/bëj* dhe mund të paraprijë format e pashtjelluara si *gerund*, *pjesore* dhe më rrallë *paskajore* (*infinitiv*). Ajo shpesh pararendet në shembujt në shqip.

(23) *We don’t want to initiate an inquiry but we are in process of so doing.*

(*Nuk duam të nisim një hetim, por jemi në proces të tillë.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1532)

(24) *Ishte thjesht doza e largësisë apo e yllëzimit, në mund të quhej kështu, që kishte çdo njeri dhe që në fund të fundit përbënte një nga të fshehtat e tërheqjes së tij.*

(I. Kadare, Prilli i thyer: 87)

Në shembujt në të dyja gjuhët si forma e gerundit ashtu dhe ajo e paskajores duhet të ndiqen gjithmonë nga fjala *so*, e cila nënkupton elementët paraprijës. Në shembullin shqip fjala zëvendësuese *kështu* është pjesë e fjalisë së ndërmjetme që shpreh vlerësimin e folësit ndaj thënies.

### B Zëvendësimi në përbërësin foljor

Si në anglisht dhe në shqip zëvendësimin foljor e kryen folja *do* (*bëj*). Kjo folje vepron si fjalë koke e përbërësit sintaksor foljor dhe pozicioni i saj në këtë përbërës është gjithmonë fundor.<sup>129</sup>

(25) *She doesn’t play much golf now, though she certainly used to do.*

(*Ajo nuk luan aq shumë golf tani, edhe pse luante shumë më parë.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1525)

<sup>129</sup> Halliday, M. A. K., Hasan, R., *Cohesion in English*, Longman, 1976, f. 112

(26) – *Desha ta shes përpara se të mbyllem në kullën e ngujimit, - vazhdoi malësori. - Kemi nevojë, or djalë, mirëpo, po nuk e shita unë, s'ka njeri tjetër në shtëpi që ta bëjë këtë punë.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 195)

Në rastin e zëvendësimit foljor në gjuhën shqipe elementi paraprijës rimerret me përsëritje të drejtpërdrejtë më shpesh sesa me zëvendësim. Folja *bej* e gjuhës shqipe nuk është shumë prodhimtare si fjalë zëvendësuese. Si e tillë ajo mund të shoqërohet me *këtë gjë/punë*.

Një aspekt tjetër i zëvendësimit foljor në anglisht është se ai mund të zgjerohet duke kapërcyer kufijtë e fjalisë.

(27) *I didn't touch the television set, but Percy might have done.*  
(*Nuk e preka televizorin, por Persi mbase Δ / mund ta ketë bërë.*)

(Greenbaum, S. Quirk, R. (1993), *A student's grammar of English language*, Longman: 251)

Ashtu si fjala zëvendësuese emërore *one* fjala zëvendësuese *do* përdoret si element koheziv kur duam të kundërvëmë, por ato dallohen nga njëra-tjetra për sa i takon numrit të elementëve që ato nënkuptojnë, ndërsa *one* mund të zëvendësojë vetëm emrin folja *do* mund të zëvendësojë ose një folje, ose një fjali të tërë.

(28) *John is smoking more now than*

- a) *Mary is doing*
- b) *he should be doing*
- c) *he used to do*
- d) *he was doing before.*

(*Xhoni po pi më shumë duhan tani se sa*

- a) *Mary Δ*
- b) *se sa duhet Δ*
- c) *se sa pinte*
- d) *se sa pinte më parë)*

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 115)

(29) *He was working harder than*

- a) *he had ever done before.*
- b) *his son was doing*
- c) *I've been able to do.*

(*Ai po punonte më shumë se*

- a) *Δ kurrë më parë*
- b) *sa Δ djali i tij*
- c) *sa punoja unë.*)

(po aty)

Siç shihet qartë në shembujt e mësipërm shqip rimarrja realizohet me elipsë dhe jo me zëvendësim. Fjala zëvendësuese *do* mund të ndiqet nga një përbërës emëror në funksionin e kundrinorit dhe kryesisht nga përemri vetor, veta e tretë, numër njëjës *it*, si dhe përemrat dëftorë *that* dhe *this*.

(30) *If we are going to live together, we may as well do it properly.*  
(*Nëse do të jetojmë bashkë duhet të jetojmë siç duhet Δ.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1532)

(31) *Ai e ndezi zjarrin me ngathësi, që tregonte se e bënte këtë gjë tepër rrallë.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 167)

Elementi zëvendësues *do so* (*bëj kështu, ashtu ose ashtu, kështu bëj*) shërben si një përbërës sintaksor foljor anaforik, i cili në shumë raste është variant më formal i fjalës zëvendësuese *do*. Ajo përdoret gjithashtu për të shprehur aprovim ose ngjashmëri me çfarë është thënë më lart në fjalinë dëftore

(32) *I had a good time tonight.*  
`So did I, `I say, staring down at the bench.  
(-Ja kalova shumë mirë sot.  
-Edhe unëΔ, - them unë, duke parë poshtë në stol.)

(Kinsella, S., *Can you keep a secret*: 211)

Siç shihet nga shembujt fjala zëvendësuese *so/ashtu* mund të paravendoset ose mund të ruajë pozicionin fundor. Ajo nuk ndjek foljen *do* kur kundërvëmë dukurinë.

(33) *I didn't invite him, but I did Pat. dhe jo - but I did so Pat.*  
(*Nuk e ftova atë, por ftova Pat-in. dhe jo - por bëra kështu me Pat-in*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1530)

Fjala zëvendësuese foljore *do* dhe *jo do so* shërben si anaforë e përbërësit sintaksor foljor që shpreh gjendje, si në shembullin e mëposhtëm.

(34) *He liked it. At least he said he did. dhe jo did so.*  
(*Ai e pëlqeu atë. Të paktën kështu tha.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1530)

Në shembujt e mëposhtëm në anglisht struktura e fjalës ose shprehjes zëvendësuese ndryshon nga struktura e elementit të nënkuptuar, ndërsa në shqip të dy elementët, ai paraprijës dhe anafora, janë formë e shtjelluar, rrjedhimisht nuk kemi ndryshim të strukturës.

(35) *We didn't complain: there was no point in doing so, dhe jo (there was no point in doing). (in doing so = in complaining).*

(*Ne nuk u ankuan: nuk kishte kuptim ta bënim këtë. dhe jo nuk kishte kuptim të bënim ashtu.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1530)

Folja zëvendësuese *do (bëj)* është gjithmonë anaforike. Ajo zëvendëson në mënyrë të përsëritur elementin paraprijës, si e tillë, është burim primar i kohezionit brenda një teksti.

Shprehja paraprijëse, pothuajse në më të shumtën e rasteve, vjen para elementit anaforik. Kjo ndodh sepse autori i tekstit kërkon të jetë i qartë dhe të shmangë keqkuptimin. Vetëm në pak raste *do* është kataforike, dhe kjo ndodh vetëm brenda fjalisë. Por, në kushte të caktuara zëvendësimi foljor përdoret edhe si ekzoforë (zëvendësim situativ), për shembull, kur paralajmërojmë dikë që e zëmë duke bërë diçka të ndaluar.

(36) *If Kim does, will you accept nomination too?*

(*Meqë e ka bërë dhe Kimi do ta pranosh dhe ti emërimin?*) [zëvendësim kataforik (cataforic substitution)]

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1524)

(37) *I shouldn't do if I was you.*

(*Unë nuk do ta bëja po të isha në vendin tënd.*) (zëvendësim ekzoforik (situativ))

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 128)

Në shembullin (36) katafora gjendet brenda fjalisë dhe nuk kontribuon në kohezionin e tekstit. Përveç qëllimit të autorit për t'i dhënë ngjyrim stilistikor tekstit, katafora nuk përdoret në periudhë, sepse në një rast të tillë përpunimi i tekstit do të kërkonte krijimin e një hapësire boshe, e cila do të mbushet kur të jepet përmbajtja e nevojshme. Por nga ana tjetër katafora e motivon lexuesin në vazhdimësinë e leximit. Në shembullin (37) folësi simulon një ndërlidhje tekstore për të sugjeruar se veprimi i ndaluar është pjese e diskutimit.

Në gjuhën shqipe një element zëvendësues është edhe folja *ndodh/ndodh kështu*. Ekuivalenti i saj në anglisht *happen* është në përgjithësi folje e veprimit shumë e ngjashme me foljen *do*, por ndeshet më rrallë.

(38) *We came back early because it started to snow which happens sometimes even in May.*

(*U kthyem më herët, sepse filloi dëbora, gjë që ndodh me raste, madje dhe në Maj.*)

(Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP: 1533)

Fjala zëvendësuese *do* përdoret më shumë në gjuhën e folur sesa në atë të shkruar, dhe më shumë në anglishten Britanike sesa në atë Amerikane. Ajo zëvendëson pothuajse çdo folje. Në qoftë se përbërësi sintaksor paraprijës përmban vetëm një fjale-folje (në kohën e shkruar apo në të tashmen, në formën pohore dhe në mënyrën dëftore), zëvendësimi përdoret në mënyrë të rregullt në anglishten britanike dhe atë amerikane.

(39) *Does Jean sing? No, but Mary does.*

(*Këndon Xheni? - Jo, por Meri po.*)

(po aty)

Në shembullin shqip fjalia qëndron më mirë e lidhur me pjesëzën *po*. Më së shumti përsëritja ndodh për të përforcuar idetë dhe faktet që autori dëshiron të vërë në dukje në mënyrë të veçantë. Si në zëvendësimin emëror, ashtu dhe në atë foljor rëndësia e vazhdimësisë (rimarrjes me elemente zëvendësues) qëndron në faktin se konteksti i kësaj vazhdimësie është kontrastues, d.m.th, është një rrethanë tjetër e kryerjes së veprimit ose ka një ndryshim në kohën, mënyrën dhe formën pohore-mohore të foljes.

Por pavarësisht nga këto raste fjala kokë e përbërësit foljor nuk ndryshon kuptim dhe anafora foljore nuk bën thjesht një referim por një konfirmim pozitiv.

- (40) *Shall I call the doctor?*  
 a) Haven't you **done so**?  
 b) When will you **do so**?  
 c) Please, **do so** as soon as possible.  
 (Ta thërras doktorin?—  
 a) S'e ke bërë?  
 b) Kur do ta bësh?  
 c) Të lutem bëje sa më shpejt.)

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 123)

Halliday dhe Hasan, autorë të "Cohesion in English", i cili ka shërbyer si pikë referimi për studiues të mëvonshëm të kohezionit, theksojnë se përdorimi i **do** si zëvendësues zgjidh dykuptimësinë në disa raste, si:<sup>130</sup>

- (41) *What are you doing here? - We're mycologists and we are looking for edible mushrooms. - Yes we are doing too.*  
 (Çfarë po bëni këtu? - Ne jemi studiues kërpudhash dhe po kërkojmë kërpudha të buta. - Po edhe ne këtë po bëjmë.)

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 115)

Në shembullin (41) fjalia e fundit pa fjalën *doing* do të interpretohej "we are also mycologists". Do gjithashtu shoqërohet në përdorim me kontrast, ku një element i ri kontrastohet me një element paraprijës.

- (42) *John is smoking more now than Mary is doing/he should be doing/he used to do/he was doing before*  
 (Xhoni po pi më shumë duhan tani sesa Meri/duhet të pi/pinte/vazhdonte të pinte.) (po aty)

### C. Zëvendësimi fjalior

Zëvendësimi fjalior nuk nënkupton (rimer ) një element brenda fjalisë, por një fjali të tërë. Duke qenë një lidhje formale (gramatikore) dhe jo semantike, zëvendësimi përgjithësisht ruan të njëjtën strukturë me elementin që zëvendëson.

- (43) *Is there going to be an earthquake? - It says so. (there's going to be an earthquake)*  
 (Do të ketë tërmet? - Kështu thuhet.)(Do të ketë tërmet)

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 130)

- (44) *-Ai malësori atje, te rruga, ka qenë këtu?*  
 -Po, pikërisht. Na tregoi bujtinari për të, apo jo?  
 - Po, ka tri ditë që kaloi këndeje për të dhënë taksën e gjakut, kështu na tha. (ka tri ditë që kaloi këtu për të dhënë taksën e gjakut.)

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 116)

Fjalët zëvendësuese *so/kështu* nënkuptojnë fjalinë paraprijëse dhe foljet *says/thotë* janë elemente kontrastues të cilat ndodhen jashtë fjalisë se presupozuar. Në gjuhën angleze zëvendësimi fjalior përdoret në fjalitë e përbëra kundrinore. Në secilën nga këto fjali zëvendësimi shprehet pozitivisht me fjalën *so* dhe negativisht me fjalën *not*.

- (45) A: - *Will Oxford win the next boat race?*  
 B: - *I hope so/not. (that Oxford will win/ that Oxford will not win)*  
 (A: - Do të fitojë Oksfordi në garën tjetër me varka?  
 B: - Kështu shpresoj/Nuk shpresoj kështu (që Oksfordi do të fitojë/nuk do të fitojë në garën tjetër me varka.)

(Greenbaum, S. Quirk, R. (1993), *A student's grammar of English language*, Longman: 253)

- (46) *- A ka pasur grindje të vjetër për këto kufij? - Iu kthye Besiani bujtinarit. - A ka pasur vrasje? - Tjetri lëshoi një fërshëllimë. - Po si jo, zotni. Është një rrip toke që s'kërkon veç mort.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 91)

Me foljet *say* dhe *believe* fjala zëvendësuese *so* mund të gjendet në pozicion fillestar. Në gjuhën shqipe përdoret ndërtimi *kështu/ashu* ndodh, thuhet etj.

- (47) A: - *Most people are backing the Oxford crew.* B: - *So I believe.*  
 (A: - Shumica e njerëzve po mbështesin skuadrën e Oksfordit. B: - Kështu besoj.)

(Greenbaum, S. Quirk, R. (1993), *A student's grammar of English language*, Longman: 254)

- (48) *Diana u përpoq të hapte një bisedë tjetër, ndonëse ishte e sigurtë se ai nuk do t'i ndahej së përparmes, pa iu fashitur pezmi. Dhe ashtu ndodhi vërtet.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 70)

<sup>130</sup> Halliday, M. A. K, Hasan, R. *Cohesion in English*, Longman, 1976, f. 115

Fjala *do* si zëvendësuese foljore mund të supozojë edhe elemente të tjerë të fjalisë përveç kallëzuesit, si për shembull, një plotësor apo një rrethanor, por në këtë rast elementi kontrastues i cili krijon mundësinë e zëvendësimit nuk ndodhet jashtë fjalisë, por është i përfshirë në të njëjtën fjali. Në zëvendësimin fjalior e tërë fjalia paraprijëse presupozohet dhe elementi kontrastues ndodhet jashtë fjalisë.

(49) *Emma, don't worry. Says Jack I'm sure it will be great when we get there.*

*I hope so, I say with a weak smile.*

(*Emma mos u shqetëso, thotë Xheku. ~ jam i sigurtë se do jetë mirë kur të jemi atje. Kështu shpresoj, them unë me një buzëqeshje të varfër.*)

(Kinsella, S., Can you keep a secret: 204)

Zëvendësimi është në thelb një marrëdhënie tekstuale. Kuptimi primar i tij është ai anaforik. Si fjalë zëvendësuese fjalioare *so* është gjithmonë anaforike, por nuk është i pamundur dhe përdorimi kataforik i saj.

(50) *If he said so, he will come.*

(*Meqë tha kështu, do të vijë.*)

(Halliday, M. A. K., Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 141)

Përgjithësisht në ligjërimin dialogjik zë vend në shkallë të gjerë zëvendësimi sintaksor. Teksti dialogjik e ka bazën e vet gjuhësore-formale në çiftin pyetje-përgjigje. Fjalët zëvendësuese *so* dhe *not* (*kështu/po* dhe *jo*) janë dy format e zëvendësimit fjalior mjaft të përdorura në pyetje-përgjigje.

(51) *Is he there Mr. Darcy from Netherfield?*

*- I believe so.*

(*Është ai atje zoti Darsy nga Netherfildi?*)

*- Besoj se po.*)

(*Pride and Prejudice*, film)

Përveç se në ligjërimin dialogjik, zëvendësimi përdoret edhe në fjalitë që tregojnë raportim, kusht dhe modalitet. Edhe në këto raste zëvendësimi ka dy forma: formën pozitive me fjalën *so* dhe formën negative me fjalën *not*.

(52) *... if you have seen them so often, of course you know what they are like.*

(*Nëse i takoni kaq shpesh, sigurisht e dini se si janë ata.*)

*"I believe so" Alice replied thoughtfully.*

(*Besoj se po. - u përgjigj mendueshëm Alisa.*)

(Halliday, M. A. K., Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 131)

(53) *You are sure that elderly gentleman over there isn't your grandfather.*

*I don't think so.*

(*-A je e sigurtë se ai zotëria atje tej nuk është gjyshi yt?*)

*Nuk besoj Δ*)

(Kinsella, S., Can you keep a secret: 174)

(54) *Is she coming round? - I hope not.*

(*Po vjen ajo? - Shpresoj që jo*)

(po aty)

Fjala *so* (*po*) zëvendëson (that) *I know what they are like (e di se si janë ata); that elderly gentleman isn't my grandfather*, dhe *not* (*jo*) zëvendëson (that) *she is not coming round (s'po vjen ajo)*. Fjalia raportuese, e cila zëvendësohet me *so* dhe *not*, është gjithmonë fjali dëftore. *So* dhe *not* nuk zëvendësojnë fjali pyetëse dhe urdhërore. Në shembujt shqip fjalët *po* dhe *jo* janë pjesëza. Ato përdoren në këto raste me vlerën e një fjalie të pagjymtyrëzueshme (pa përbërës sintaksor) dhe kuptimi i tyre kushtëzohet nga fjalitë e mëparshme, me të cilat janë të lidhura nga pikëpamja kuptimore.

Në fjalitë që tregojnë raportim me rëndësi është dallimi që duhet bërë midis fjalive të raportuara dhe ato të paraportuara (fakti). Faktet dhe raportimet ndryshojnë nga njëri-tjetri, edhe pse nuk është gjithmonë e lehtë t'i dallosh ato. Faktet janë kumtime, raportimet janë riprodhim, ritregim fjalësh, thëniesh.

Duke krahasuar rastet me zëvendësim në gjuhën shqipe me ato të gjuhës angleze do të mbërrinim në përfundimin se në gjuhën shqipe elipsa përdoret më shpesh sesa zëvendësimi në fjalitë raportuese.

(55) – *Kështu që ai mund të jetë futur edhe te kjo kullë?*

*Besiami ngriti supet. - Mundet. Megjithatë s'e besoj Δ.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 172)

Zëvendësimi fjalior e gjejmë të përdoret edhe në fjalitë kushtore. *So* dhe *not* shpesh zëvendësojnë fjalinë kushtore, kur ajo fillon me lidhëzën nënrenditëse *if*. E njëjta gjë ndodh edhe kur fjalia kushtore prezantohet nga lidhëzat *assuming so*, *suppose not*.

(56) *I may come tonight. If not, I'll try to manage tomorrow.*

(*Mund të vij sonte. Nëse jo do të përpiqem të vij nesër.*)

(Swan, M. (1982), *Practical English usage*, OUP: 582)



Zëvendësimi fjalior përdoret gjithashtu kur fjalja që zëvendësohet tregon modalitet. (Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimit të folësit ndaj asaj që kumton në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv.)<sup>131</sup> *So dhe not shërbejnë si fjalë zëvendësuese për këto fjali.*

(57) A: - *Would you like cats if you were me?*

(A: - *Do t'i pëlqejë macet po të ishe në vendin tim?*)

B: - *Well, perhaps not – said Alice in a soothing tone.*

(B: - *Ndoshta jo – tha Alisa me një zë qetësues.*)

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 134)

Në shembullin (57) fjala zëvendësuese *not/jo* i referohet “*I wouldn't like cats*”/“*nuk do t'i pëlqejë macet*”.

Si në anglisht dhe në shqip, zëvendësimi fjalior shpesh shoqërohet me ndajfolje që shprehin modalitet p.sh.: *perhaps* (ndoshta), *possibly* (mundet), *probably* (ka të ngjarë), *certainly*, *surely* (sigurisht).

(58) *Perhaps we are going to have a storm.* - *Perhaps so.*

(*Ndoshta do të kemi stuhë.* - *ndoshta po.*)

(Swan, M. (1982), *Practical English usage*, OUP: 23)

Në gjuhën shqipe ndajfoljet që shprehin qëndrimin e folësit ndaj asaj që është kumtuar shoqërohen më shpesh me elipsë sesa me zëvendësim.

(59) – *Ndoshta ka hyrë në kishë nga kureshtja, ose në ndonjë shtëpi për të pirë ujë.* - *tha mjeku.* - *Ka mundësi A.*

(I. Kadare, *Prilli i thyer*: 180-181)

Në ditët tona në medie përdoret shpesh fjala “*absolutisht*”, pa qartësuar kuptimin e saj, pohues apo mohues. Kjo si fjalë e huaj nuk këshillohet, por edhe kur përdoret duhet shoqëruar me pjesëzat *po* a *jo* sipas rastit: *A e miratoni ju një qëndrim të tillë? - Absolutisht!* (nuk merret vesh, duhet kuptuar kjo, po apo jo)

Është e rëndësishme të theksohet se të tri llojet e fjalive që zëvendësohen shprehin të njëjtin kuptim në një kontekst të përbashkët.

(60) *Probably he's right.*

- *Probably so.*

(*Ndoshta ai ka të drejtë.*

- *Ndoshta po.*)

(Halliday, M. A. K, Hasan, R. (1976), *Cohesion in English*, Longman: 135)

(61) *I suppose he's right- I suppose so.*

(*Mendoj se ka të drejtë- Kështu mendoj edhe unë.*)

(po aty)

I njëjti kuptim shprehet edhe në fjalinë e mëposhtme kushtore.

Forma:

(62) “*if he is right*” (*nëse ai ka të drejtë*) do të thotë:

*Let us suppose he is right – then. (le të mendojmë që ai ka të drejtë - atëherë.)*

Gjenerativistët Halliday dhe Hasan i përmbledhin elementet zëvendësues në tabelën e mëposhtme.

Niveli i abstraksionit	Leksiko-gramatikor
Burimi primar i presupozimit	teksti
Çfarë presupozohet?	fjalë, grupe, fjali
A ruhet klasa?	po
Është plotësimi me to i mundshëm?	po
Përdoren si mjete kohezive?	po (anaforike dhe me raste kataforike)

### Perfundime

Mbështetur në arritjet e studiuesve të ndryshëm dhe mbështetur veçanërisht në teorinë e gjenerativistëve Halliday dhe Hasan në lidhje me zëvendësimin do të arrijmë në përfundimin se ky fenomen gramatikor është një mënyrë e thjeshtëzimit të strukturës gramatikore në një numër më të vogël fjalësh pa cenuar kuptimin. Në të dyja gjuhët ai ndodh në gjymtyrë të veçanta, por edhe në fjali e në periudha të tëra. Elementet zëvendësues presupozojnë elemente të tekstit duke ruajtur klasën e tyre dhe si të tilla përdoren si mjete kohezive anaforike dhe rrallë kataforike. Plotësimi i formës të plotë të përbërësve për qëllime të analizës së tekstit është i mundshëm. Si në gjuhën angleze edhe në gjuhën shqipe fjalët zëvendësuese janë të pakta. Zëvendësimi emëror në gjuhën angleze realizohet me fjalët *one/ones*. Fjalët zëvendësuese gjegjëse në gjuhën shqipe *një/ca* nuk gjejnë përdorim të gjerë si

<sup>131</sup> Grup autorësh, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1*. Tiranë, 2002, f. 261

elemente zëvendësues dhe shpesh rimarrja e drejtpërdrejtë i shprehjes gjuhësore ose rimarrja me elipsë realizojnë kohezionin e tekstit. Gjuhës angleze i njihet gjithashtu si fjalë zëvendësuese emërore fjala *same* e shoqëruar nga nyja shqese *the*. Ndryshe nga fjala zëvendësuese *one* që në të shumtën e rasteve nënkupton vetëm fjalën kokë, *the same* nënkupton një përbërës të tërë sintaksor emëror duke përfshirë çdo caktuesor në të.

Në gjuhën shqipe fjala gjegjëse e *the same* është mbiemri *i njëjtë* më shpesh i shoqëruar me emrin *gjë* duke formuar përbërës sintaksor emëror zëvendësues. Rast tjetër tipik i zëvendësimit emëror në gjuhën angleze është fjala zëvendësuese *so* dhe në gjuhën shqipe (*kështu*). Ato gjenden më dendur në letërsinë artistike si element zëvendësues emëror dhe fjalior. Si në anglisht dhe në shqip zëvendësimin foljor e kryen folja *do* (*bëj*). Kjo folje vepron si fjalë kokë e përbërësit sintaksor foljor. Ashtu si fjala zëvendësuese emërore *one* fjalët zëvendësuese *do* përdoret si element koheziv kur duam të kundërvëmë, por ato dallohen nga njëra-tjetra për sa i takon numrit të elementëve që ato nënkuptojnë, ndërsa *one* mund të zëvendësojë vetëm emrin (fjalën kokë të përbërësit emëror) folja *do* mund të zëvendësojë ose një fjalë, ose një përbërës foljor, ose një fjali të tërë. Folja *bëj* e gjuhës shqipe nuk është shumë prodhimtare si fjalë zëvendësuese.

Prandaj shumë raste të zëvendësimit të elementeve paraprijës në anglisht i përgjigjet rimarrja e drejtpërdrejtë e tyre në shqip. Më shpesh përdoret zëvendësimi fjalior me fjalët *so/ ashtu, kështu* dhe zëvendësimi emëror me fjalët *një/njëri, i/e njëjtë, i/e tillë*. Si zëvendësimi fjalior me *so*, ashtu edhe ai me *not* ndodhin rëndom në ligjërimin dialogjik.

### Bibliografi

1. Greenbaum, S., Quirk, R., *A student's grammar of English language*, Longman, 1993
2. Halliday, M. A. K., Hasan, R., *Cohesion in English*, Longman, 1976,
3. Dibra, K., Varfi, N., *Gjuhës i teksti*, shblu, Tiranë, 2005,
4. Çepani, A., *Vëzhgime rreth anaforave në gjuhën shqipe*, SF 2007, Nr. 3-4,
5. Topalli, T. *Gjuhësi Teksti*, Shkodër, 2011,
6. Grup autorësh, *Gramatika e Gjuhës Shqipe 1*, Tiranë, 2002,
7. Swan, M. (1982), *Practical English usage*, OUP
8. Huddleston, R. (2003), *The Cambridge Grammar of English Language*, CUP
9. Kinsella, S. (2003). *Can you keep a secret?* Great Britan: Black Swan.
10. Kadare, I. (2003). *Prilli i thyer*. Tiranë: Onufri.
11. Discover. (2006, Shkurt). Wright, J. (Director). (2001). *Pride and prejudice* [Motion Picture].